



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 2663/2 Prot.

Pogradec, më 16.06.2021

VENDIM

NR. 51, DATË 14.06.2021

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË POGRADEC, SË BASHKU ME DOKUMENTACIONIN TEKNIKO LIGJOR, PËR AKORDIMIN E NDIHMËS FINANCIARE Z.HALIL LAZELLARI, PËR SHKAK TË DËMTIMIT TË BANESËS, NGA RËNIA E ZJARRIT

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 8, të pikës 1 të nenit 29, të ligjit nr. 139/2015, “Për Veteqeverisjen Vendore”, të neneve 4, 7 dhe 41, Ligjit Nr. 68/2017, "Për financat e veteqeverisjes vendore", nenit 6 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 132 të Udhezimit nr.9, datë 20.03.2018 "Per Procedurat Standarte te Zbatimit te Buxhetit", si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. 144, datë 24.12.2020, "Per miratimin dhe detajimin e buxhetit te Bashkise Pogradec për vitin 2021" të ligjit nr. 45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe të kapitullit III të V.K.M nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI :

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Pogradec për mbështetje financiare të shtetasit Halil Lazellari për dëmtimin e banesës së tij nga rënia e zjarrit në datën 11.05.2021
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko ligjor të hartuar nga Bashkia Pogradec.
3. Ti akordojë familjes së shtetasit Halil Lazellari, ndihmën emergjente në vlerën prej **368 867 lekë** nga buxheti i Bashkisë Pogradec, fondi i emergjencave civile i destinuar dhe miratuar nga Këshilli i Bashkisë Pogradec për vitin 2021.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Emergjencave Civile, Strehimi dhe objekteve në Bashkëpronësi, si dhe Drejtoria e Administrimit të Çështjeve Ekonomike dhe Financiare, të Bashkisë Pogradec.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes:

KRYETARI I KËSHILLIT

Sotiraq MANGËRI

